# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432862**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Studimi i fundit ngre alarmin: Të rinjtë me obezitet përballen me rrezik më të lartë për vdekje të parakohshme – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/studimi-i-fundit-ngre-alarmin-te-rinjte-me-obezitet-perballen-me-rrezik-me-te-larte-per-vdekje-te-parakohshme/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 10:21:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 10:18:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `09710be4048ac541d113fac56fbedf7201e447434265f158d3a44371331ce9a7` |
| TEKSTI | `7976dc33e622ea6c493a560658a057234d09ac2978439a8a7e4724cd48d5a6d4` |
| PAMJA | `a7c8c69e12c05cd6cd88a16712d19d444dec7b7f42e10e24777c3c4e6995385e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0bb05675f5ea35075cf28448a013d573103ea79650647e65322840241fdca3da` |
| E MËPARSHMJA | `61ba5db7510feb3c7d71d834c01fe08ed87ed2ef3000df229d3dfa648d0c891f` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0bb05675f5ea35075cf28448a013d573103ea79650647e65322840241fdca3da`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Të rinjtë obezë rrezikojnë të vdesin më herët sipas një studimi të fundit, të realizuar nga ekspertë danezë.

Hulumtimi i tyre tregon se çdo pikë shtesë në indeksin e masës trupore (BMI) lidhet me një rritje të rrezikut për infarkt, tension të lartë të gjakut, tromboza dhe diabet. Mbipesha lidhet gjithashtu me një rrezik më të lartë për zhvillimin e disa llojeve të kancerit. Meshkujt që janë obezë në të njëzetat, theksojnë ekspertët, kanë dy herë më shumë gjasa të vdesin para moshës 55 vjeç, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre me peshë normale.

Studimi është kryer në një periudhë afatgjatë dhe ka ndjekur për rreth 33 vjet ecurinë e 6,500 burrave danezë. Në fillim të studimit, pjesëmarrësit ishin 22 vjeç. Rreth 1.5% e tyre, ose 97 persona, ishin obezë, me një indeks të masës trupore-BMI, 30 ose më të lartë.

Deri në moshën 55 vjeç, pothuajse gjysma e pjesëmarrësve që ishin mbipeshë, u diagnostikuan me diabet të tipit 2, sëmundje kardiovaskulare ose tension të lartë të gjakut. Gjatë periudhës së ndjekjes së situatës së tyre, disa prej pjesëmarrësve pësuan infarkt ose hemorragji cerebrale, ndërsa të tjerë zhvilluan tromboza në këmbë ose në mushkëri. Disa prej tyre humbën edhe jetën.

Studiuesit danezë konstatuan se çdo pikë shtesë në BMI lidhej me një rritje prej 5% të rrezikut për infarkt. Rreziku për tension të lartë të gjakut dhe tromboza rritej me 10%, ndërsa ai për diabet me 20%. Mbipesha dhe obeziteti lidhen me një sërë problemesh shëndetësore.

5 Starton Ferma Vip 2! Përballje, surpriza, debate dhe të papritura,...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Përveç sëmundjeve kardiovaskulare dhe diabetit, ato mund të shoqërohen edhe me çrregullime të sistemit gastrointestinal, probleme ortopedike, dhimbje kronike të kokës dhe depresion, ndërsa lidhen gjithashtu me rrezik më të lartë për zhvillimin e llojeve të caktuara të kancerit.

#Obezitet #vdekjeteparakohshme

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



LIFESTYLE

**Kush janë shenjat më besnike dhe më...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 21:32



LIFESTYLE

**“Një surprizë mund t’ju ndryshojë...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 10:32



LIFESTYLE

**Pse gërhitja e partnerit mund të...**

Taulant Halili · 12 Sht

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.